

# Dashuria pretenduese që na rrit

“Dashuria jote pa pretendime më lë pa forcë;  
pretendimi yt pa dashuri më bën të dorëzohem;  
pretendimi yt pa durim më shkurajon ;  
dashuria jote pretenduese më rrit”

Henri Caffarel

Në këto vitet e fundit është ngritur një debat në botën e psikiatrisë rreth "narcizizmit". Me rastin e publikimit të numërit të ri të Diagnostic and Statistical Manual of Mental Disorders (strument për dianjostikimin e shqetësimeve psikologjike të përdorur në psikiatri dhe nga psikologët në të gjithë botën) ishte propozuar fshirja e fjalës “narcizizëm” nga lista e shqetësimeve mendore. Ishin të ndryshme arsyet që shtynin drejtë këtij vendimi: nga njëra anë vështirësia për të dhënë kritere shkencore të qarta për diagnozën, nga ana tjetër presioni i kompanive amerikane të sigurimeve të cilat bazoheshin në arsyet ekonomike por thelbi i temës ishte se “narcizizmi” mund të konsiderohet si një zgjedhje jete, një mënyrë të të jetuari dhe jo një patologji. Në numrin e ri , DSM-5, narcizizmi u konsiderua si një shqetësim i personalitetit por diskutimi nuk u konsiderua akoma i mbyllur. Në fakt pas kësaj fjale fshihet një problem akoma më i madh i cili tejkalon çdo kufi të psikiatrisë e hap çështje që kanë lidhje me antropologjinë. Otto Kernberg në lectio magistralis të mbajtur rreth këtij argumenti në Universitetin e Milanos-Bicocca të shtunën më 28 janar të 2012 deklaroi hapurasi: “ Më lejonin të them që sistemi amerikan i klasifikimit shtiret se është një sistem shkencor, por në të vërtetë nuk është i tillë, është një sistem politik i cili pasqyron ideologjinë e American Psychiatric Association”. Nga i gjithë ky debat del një e vërtetë shumë e rëndësishme për ne: narcizizëm është diçka më shumë se një patologji psikologjike sepse ajo prek më shumë shpirtin sesa psiken e njeriut. Nëse psikologjia do të deklaronte që narcizizmi nuk i përket fushës së saj, nuk do të ishte, nga ky këndështrim, një gabim por njohja hapurazi e nevojës për një mirëkuptim të qënjes njerëzore në mënyrë më të gjërë e cila konsideron edhe përbërësit e saj shpirtëror dhe ekzistencial. Narcizizmi përshkruhet si “tendencë dhe sjellje psikologjike të atij i cili konsideron vetveten, kualitetet e tij fizike dhe intelektuale qendër ekskluzive të interesave të tij dhe i konsideron një objekt të një adhurimi, ndërkohë është indiferent ndaj të tjerëve rreth të cilëve injoron apo shpërfill vlerat dhe veprat. ( marrë

nga treccani.it). Në këtë kuptim zgjedhja e të "jetuarit për vetveten" shkon përtej aspekteve psikopatologjike. Paradoksi është që edhe ai i cili mund të ketë kryer training më të mirë të psikoterapisë e që mund të ketë një strukturë të mirë personaliteti mund të zgjedhë të jetë një narcizoid . Me pak fjalë mund të themi se një person me një psikologji të shëndoshë mund të zgjedhë të jetë një misionar i mrekullueshëm ose një terrorist i shkëlqyer, një mjek mjaft i aftë në komunikimi me pacientët e tij ose një mafjuz i aftë në menaxhimin e trafikeve jashtligjore dhe vrasjeve, një bashkëshort/e që ndjehet mirë duke qenë i ndershëm me partnerin/en ose një që në të njëjtën mënyrë ndjehet mirë me tradhëtit e tij/saj. Edhe fakti i të qenurit "single", në rat kur është një zgjedhje e lirë e mënyrës së jetuarit, mund të jetë një shenjë e orientimit narcizist. Të qenurit "single" është bërë një mënyrë e vecantë jetese në ditët e sotme. Përdorim një fjalë në anglisht pasi në gjuhën italyane nuk ekziston një fjalë, pasi kjo mënyrë jetese ishte e pamendueshme deri pak vite më parë. Një shenjë e përhapjes e kësaj mënyrë të jetuarit janë propozimet e ndryshme që gjenden në internet. Fenomeni i të qenurit "single" është mjaft i komplikuar dhe ka arsye të ndryshme, por me siguri është bijë e vëmëndjes që mendimi bashkohës i kushton. Shoqëria konsumiste inkurajon jetën single sepse personat që jetojnë vetëm konsumojnë akoma më shumë se mund të konsumonin nëse jetonin bashkë. Pak a shumë në mënyrë jo të drejtëpërdrejtë edhe psikoterapitë mund të jenë një mjet që nxisin këtë koncept të mënyrës së jetuarit të bazuar rreth individit në vetvete dhe rreth pozitivitetit e të qenurit single. Është shumë lehtë që një psikoterapeut të mund të inkurajojë një të ri për tu larguar nga prindërit e të jetojë vetëm, siç është vërtetuar statistikisht që përqindja e ndarjeve midis një çifti është më e lartë kur këto bëjnë psikoterapi. Shumë single do të dëshironin të ndanin jetën e tyre më dikë por nuk mundën pasi janë të detyruar nga rrethanat e jetës. Ndërsa për disa të tjerë të qenit single është një zgjedhje pasi në një mënyrë pak a shumë të ndërgjeshme vendosin të mos jetojnë me askënd, vendosin të mos ja dedikojnë askujt jetën e tyre. Nëse narcizizmi është sjellja e personit i cili bën veten e tij një qendër ekskluzive të interesave të tij dhe është indiferent ndaj të tjerëve, atëhere personi single më koherent është pikërisht ai i cili jeton shumë mirë edhe pa praninë e Zotit. Ndaj problemi kryesor nuk është të një natyre psikologjike por antropologjike dhe filosofike. Cila është figura e "njeriut" që kemi në mendje? Përse kaq shumë njerëz arrijnë në përfundimi së është më mirë të jetosh vetëm? Përse disa njerëz nuk ndjejnë më dëshirën nevojën të jetojnë një jetë bashkë me të tjerët? Përse ndodh që në shoqërinë tonë shumë persona edhe pse jetojnë bashkë me të tjerë mbajnë një qëndrim individualist dhe narcizist? Nuk ka gjë më të largët me Ungjillin se ajo e

largimit nga bashkësia dhe kërrysja mbi vetvete. Egoizmi dhe mendjemadhësia janë veset më të frikshme. Kulti i vetvetes është sfondi i një sjelljeje adhurimi e cila kritikohet nga e gjithë zulimi biblik i cili në të kundërtën deklaron se arrihet kulmin e mirëqënës kur “ Duaje Zotin, Hyjin tënd, me gjithë zemrën tënde, me gjithë shpirtin tënd, me gjithë fuqinë tënde, dhe me gjithë mendjen tënde dhe të afërmin tënd porsi vetveten” (Lc 10,27) e “dashuria më e madhe që dikush mund të tregojë është: të japë jetën e vet për miqtë e vet.” (Gv 15,13). Në mendjen e një të krishteri në qendër nuk ndodhet “individ”, por “person” i cili shikohet gjithmonë në mardhënje me Zotin dhe me të tjerët. Një shoqëri e bazuar mbi individin e mbyllur në vetvete nuk ka një të ardhme por është thjeshtë një masë e vogël rrënojash. Një shoqëri e bazuar mbi një individ i cili ka lidhje shoqërore me të tjerët dhe është i hapur i cili shkon përtej realitetit të vetvetes shpërthen në kreativitet dhe në jetë. Nëse fshihet Zoti nga ekzistenca jonë është shumë më e lehtë të biesh në situatën e murrjes së vetvetes. Sa më shumë mohohet bota e jashtme aq më pak jemi të aftë të dalim nga vetvetja. Sa më pak praktikohet meditimi dhe dëgjimi i Fjalës më i madh është rreziku që të bëhemi e të shndërrohemi në narcizoid. Përkthimi narcizoid i një individi pasqyrohet më pas në një izolim dhe mbyllje të një çifti. Në fakt edhe çiftet nëse largohen në mënyrë të tepërt nga familjarët dhe shoqëria e nëse nuk janë të drejtuara nga Zoti, rrezikojnë vdekjen nga aksfizia. Nëse është e vërtetë që ndonjëherë mugesia e kufijve midis familjeve të origjinës krijon probleme në jetën në çift është e vërtetë edhe fakti që mardhëniet kalimtare o pothuajse totalisht jo të pranishme nuk ndihojnë bashkimin e një çiftit, përkundrazi e fundosin akoma më thellë. Ndoshta edhe në këtë kuptim duhet kërkuar shpjegimi se përse jo rrallë herë ndjehet një nevojë e domosdoshme për të kërkuar lidhje të reja nëpërmjet rrjeteve sociale. Për më tepër, këto lidhje mund të funksionojnë si një shtyrje rreth këndvështrimit personal individualistik dhe nuk ndihmojnë përndryazi shpeshherë behen një arratisje nga jeta në çift. Ajo që është e nevojshme është zbulimi i vlerave të një mardhënjeje të fortë, pretenduese e impregnate për besikëri e ndershmëri ndaj të afërmeve dhe shoqërisë. Duhet një shtytje teologale që të shndërrojë të gjithë ekzistencën tonë dhe mardhëniet tona në vënd që të limitohemi thjesht në një sforcim moral. Duhet të rizbulojmë vlerën e të luturit në familje dhe rolin e domosdoshëm të së djelës si një ditë e Zotit. Duhet shijuar bukuria e të zbuluarit " bij" të dashur nga I Ati Në Jezus në shpirtin e shejtë. Për ta thënë me fjalët e famshme profetike të Karl Rahner: « Kristianët e të nesërme o do të jenë hyjnorë ose nuk do të jenë ». Duhet rizbuluar dimensionin ekleziastik e shtëpive tona. Janë ato vallë me të vërtetë tempuj në të cilat banon Shpirti i Shejtë, laboratorë shprese dhe dashurie, vende në të cilat vendoset

çdo ditë ti "dedikohemi e përkushtohemi njëri tjetrit të gjithë bashkë"? Sipas Caffarel një dashuri e tillë është shumë shumë pretenduese e cila sjell domosdosmërisht daljen nga vetvetja për tu futur në brëndishmëri të botës së tjetrit e cila është kaq ndryshe nga e imja. E gjithë kjo kërkon një vdekje të vërtetë siç thoshte don Tonino Bello: "të duash, kuptimi i foljes të vdesësh". Nuk ekziston një "unë" i dobët në këtë dashuri. Në të kundërt duhet një "unë i fortë", shumë i fortë për të arritur në vendim e të dashurit tjetrin deri në atë pikë sa të jesh i gatshëm të vdesësh për të. Kështu siç edhe të falësh nuk është shenjë dobësie, të vuash për tjetrin nuk është mazokizëm. Nëse në të kaluarën bëhej shumë shpesh gabimi e ngatërrohej një problem psikologjik me një dimension shpirtëror, sot është më e lehtë gabimi në të kundërt. Ndodh në këtë mënyrë që realiteti shpirtëror shpesh herë interpretohet në kuptimin psikologjik. Ndoshta edhe ne priftërijtë në mënyrë këmbëngulëse dërgojmë tek psikologët çiftet të cilat po kalojnë një periudhë krize duke i mohur një analizë shpirtërore. Për shembull nëse problemi në një çifti lind ka një shqetësim paranoik të personalitetit është e qartë që është e domosdoshm dërgimi dhe ndërhyrja e një psikiatri i cili mund ti përshkruaj një terapi të përshtatshme mjekësore dhe nëse jo të një procesi psikoterapeutik. Për nëse kriza në çift shkaktohet nga një kërkim narcizist i vetvetes (e cila mund të manifestohet në mos besnikëri, mos ndershmëri ose në të qenurit shumë të përkushtuar ndaj punës duke lënë në këtë mënyrë pasdore familjen dhe fëmijët) atëherë ndoshta ajo që duhet të shërohet është sfera shpirtërore. Jeta në çift nuk është e shëndosh vetëm duke u ushqyer mirë, nga ushtrime fizike apo nga një higjienë mendore e mirë. Nuk është e mjaftueshme as fakti që dikush ka një aftësi komunikimi shumë të lartë. Atë Caffarel ka kaluar tërë jetën e tij duke i mësuar çifteve se sa e rëndësishme është një jetë aktive për mirëqenjen e një çifti. Walter Kasper në shkrimin e kërkuar nga papa Françesku për asamblenë e jashtëzakonshëm të kardinalëve në përgatitjet për seminarin rreth families në 2014 dhe në 2015 deklaroi se " për shkak të kushteve të sotme të cilat janë kundër familjes , familja moderne e bashkuar ndodhet në vështirësi. (...) Kishat shtëpiake mund të jenë një përgjigje (...) Kemi nevojë për familje të medhaja të një lloji të ri. Për të bërë të mundur mbijetesën e familjeve të bashkuara, duhet futur në një bashkëjetesë familjare nëpërmejt gjeneratave në të cilën sidomos gjyshërit duhet të luajnë një rol të rëndësishëm, në rrethe familjesh të miqëve dhe shokëve, ku fëmijët mund të gjejnë një strehë në mungesë të prindërve , të moshuarit , të divorcuarit dhe prindërit e vetëm mund të gjejnë një familje. Shoqëria shpirtërore shpeshherë përbën një sferë dhe një klimë ku mund të marrin pjesë shoqëria familjare" ( Ungjilli i Familjes, Queriniana, p. 37). Kjo mënyrë e të jetuarit përbën një burim të çmuar për të

mbështetur familjet të cilat kanë vuajtur nga pësojat e krizës ekonomike të këtyre viteve arsye më shumë përse kjo mënyrë duhet mbështetur. Equipe Nôtre Dame mund të jenë embrion të këtyre "shoqërive shpirtërore" kaq të domosdoshme për burrat dhe gratë të kohës sonë. Ne priftërijtë dhe laikë të thirrur për të jetuar në equipe kemi marrë dhuratën më të mrekullueshme të kungimit që na lejon të fitojmë mbi narcizizmin gjithmonë e më shumë i fshehur tek ne dhe sot ndoshta më i përhapur se kurrë. Këtë duratë të çmuar nuk duhet ta mbajmë vetëm për ne . Equipe Nôtre Dame është një zë të cilit nuk i duhet fshehur merita për vërtetat që pohon është një talent i cili nuk duhet groposur përkundrazi duhet të qarkullojë dhe duhet ofruar sa më shume çifteve e priftërinjve. Jeta ka një kuptim të kundërt në krahasim të narcizizmit dhe të individualizmit sepse ngall tek të gjithë atë dashuri pretenduese që na rrit

P. Francesco Saverio Colonna

Këshilltarë shpirtëror i Equipe Italia

Na trasformo në një dhunti

Për krishtëlindje është traditë të bëhen dhuarat. Një mal me dhuarata, kuintale letrash zbulimi e kilometra me fjongo të arta, kartolina urimesh të mëdhaja si çarçafë. Mendojmë se kjo është mënyra më e mirë për të falenderuar dikë të cilit i jemi mirënjohës. Por kjo është një mënyrë shumë e lehtë shumë me e rehatshme. Si të krishterë kemi detyrimin, jo të bëjmë dhurata, por të transformohemi e të jemi në një dhuratë për të tjerët. Duhet të bëjmë që jeta jonë të jetë një dhuratë pa limite për të gjithë. Sepse çdokush nga ne është borxhli ndaj tjetrit e mbi gjithçka duhet të kemi kurajo të pasqyrohemi në fjalët e Lukas: të gjejmë thjeshtësinë. Të fshijmë një krishtëlindje kolosale dhe mekanike për të zbuluar krishtëlindjen autentike të vërtetë duke u pasuruar me atë varfëri.

Alessandro Pronzato, "Vangeli scomodi"

## Çiftet në takim Sinodo

*Në mbledhjen e jashtëzakonshme të familjes ishin të pranishëm bashkë me 191 etërit sinodiali edhe trembëdhjete çifte të martuar. Kisha e peshkopëve dëgjoi çiftet por edhe ato folën me dorë në zemër me sinqeritet dhe dëgjuan me thjeshtësi ashtu siç u kishte kërkuar papa Françesku. ndoshta njohëm vetveten duke lexuar fjalët e atyre çifteve, gjetëm një pjesë tonën, të jetës sonë bashkëshortore dhe të jetës së personit që na qëndron pranë. Në mënyrë të veçantë i equipier mundën të gjenin vetveten në fjalët e Hermelindës dhe të Arturit, përgjegjës të rrethit të Brazilit.*

### Hapja e çiftit ndaj jetës

*Dëshmia e Hermelindës dhe Artur Zamperlini në javën e shtatë të Mbledhjes së përgjithshme (Congregazione generale.)*

Duam të shprehim mirënjohjen tonë Atit të shenjtë për besim që na dha nëpërmjet thërritjes në këtë mbledhje. Jemi shumë të nderuar edhe pse nuk e fshehim frikën tonë për një përgjegjësi të tillë. Jemi të pranishëm këtu si një çift duke sjellur jetën tonë familjare dhe fetare. Ne nuk jemi teologë dhe as ekspertë. Ajo që na jep siguri është vetëm besimi i Zotit. Jemi Hermelinda dhe Arturo, brazilianë, 41 vjet të martur, kemi tre djem, një vjază dhe një nip. Bëjmë pjesë të Equipe Nôtre Dame që nga 1994 dhe aktualisht jemi përgjegjës për shtetin e Brazilit për këtë lëvizje në të cilën mbizotëron karizma dhe jeta shpirtërore e çifteve. Kjo lëvizje është krijuar që më 1938 dhe është e pranishme në 70 vende të botës. Aktualisht jemi 137.200 anëtarë në të gjithë botën, prej të cilëve 45.500 ndodhen në vendi tonë. Na kërkuan të flasim rreth temës "Hapja e çifteve ndaj jetës", pjesa e tretë e tekstit Instrumentum laboris, kapitulli I (*Gesù, duke marrë dashurinë njerëzore e bëri atë akoma më perfekte (cf. GS49), duke i dhuruar më pas gruas dhe burrit një mënyrë të të re të dashurit, e cila ka rrënjët e saj të thella në të pandërryeshmen dashuri për Zotin. Në këtë këndvështrim letra e Efesianëve ka identifikuar në dashurinë bashkëshortore midis një burri dhe një gruaje "misterin e madh" i cili bën prezent në këtë botë dashurinë midis Krishtit dhe kishës (cf. Ef 5,31-32). Ato zotërojnë karizmën (cf. 1Cor 7,7) për të fortësuar kishën me dashurinë e martesës dhe nëpërmjet detyrës së prokreimit dhe edukimit të fëmijëve. Të lidhur nga një nyje e shenjtë e pasthurur, çiftet jetojnë bukurinë e dashurisë, të të qënit baba, të të qënit nënë dhe kanë dinjitetin për të marrë pjesë në këtë vepër krijuese të Zotit.) Fillojmë duke përmendur një shkrim të Shrimtit*

Të Shenjtë:: Gen 1: 27-28 “ Hyji krijoi njeriun në përngjasimin e vet, e krijoi në përngjasimin e Hyjit; i krijoi mashkull e femër. Hyji i bekoji dhe u tha: Shtohuni e shumohuni e mbusheni tokën dhe sundojeni atë!” Zoti na krijoi burrë e grua në mënyrë të tillë që të mund të bahoheshim në një mish të vetëm, sepse duhemi me Dashurinë që lind nga vetë Ai, në mënyrë që të ndërtojmë në bashkëpunim me njëri tjetrin me anë të kësaj dashurie e të krijojmë jetë. Nuk është e lejuar asnjë çift që të mbajë këtë dhunti dhe frutet e jetës bashkëshortore për vete. Duke kujtuar qëllimin e kësaj lëvizjes sonë, duke ndihmuar çiftet të jenë të shenjtë, Atë Henri Caffarel, fondatori ynë , deklaron: “asnjë çift nuk ka të drejtë të jetë steril”. Është e llogjikshme që steriliteti nuk është fjalë që limitohet vetëm tek fakti i mos të pasurit fëmijë. Ne e kuptojmë si një sjellje e orientuar drejt dhuntisë krijuese së Zotit e cila shprehet nëpërmjet mënyrave të ndryshme të dashurisë bashkëshortore. Burri dhe gruaja, duke përcjellë jetë, si çift e si prindër, bashkëpunojnë në mënyrë të bashkuar në veprën e Krijuesit. Akti seksual është i ligjshëm, i çmuar dhe i bekuar nga Zoti, dhe kënaqësia që ndjehet ndihmon në gëzimin e jetës dhe në krijimin e një personaliteti të shëndoshë. Është një shprehje dashurie, e cila në fillim mund të jetë pasion, por e cila duhet të humanizohet gjithmonë e më tepër. Çiftet në dashuri shprehin me anë të trupit zemrën e tyre. Për të qenë në sintoni me njëri tjetrin është e nevojshme të dimë të rrisim dëshirën dhe një erotizëm të shëndoshë. Duhet të jemi gjithmonë pasional dhe të kujdesshëm ndaj njëri tjetrit. Mënyra se si administrojmë jetën tonë seksuale është shumë e rëndësishme për të humanizuar krijesat. Atë Caffarel propozon një rrugë tërheqëse: nga seksi në dashuri. Çifti është vendi në të cilin ndërthuren tre funksionet e seksualitetit: mardhënia, qejfi dhe fertiliteti. Çifti krijohet duke ndërthurur në mënyrë të ekuilibruar këto tre dimensione. Seksualiteti jetohet në mardhënie me të afërmin dhe me zotin dhe rikthehet në një gjuhë dashurie, bashkëjetese dhe jete. Është e nevojshme të udhëheqësh çiftet në një perfeksionim njerëzor dhe të krishterë edhe në aspektin e tyre seksual. Seksualiteti është një faktor shenjtërimi dhe tani lind nevoja për ta shpëtuar nga një erotizëm i sëmurë i cili shndërron qënjen njerëzore në një dimension të vetëm. Të sjellit në jetë fëmijë është një shenjë dashurie madhështore, një dhurim jete. Do të thotë ti japësh mundësinë një tjetër qenje njerëzore të jetë pjesë e kësaj aventure jete, dashurie, zbulimi, takimesh dhe ne zhytjen përfundimtare në zemrën e Zotit e cila është realizimi më suprem i të gjithë ekzistencës. Çifti nuk është fekond vetëm sepse lind fëmijë por sepse duhen dhe duke u dashur i hapen jetës. Kjo është diçka shumë ndryshe nga dy persona të cilët, për një zgjedhje të tyre të lirë, në mënyrë egoiste, vendosin të mos e mirëpresin jetën. Qëllimi kryesor i martesës dhe familjes është ai i të qenit në shërbim të jetës

për këtë arsye çdo akt marterësorë duhet të jetë i gatshëm për të përcjellë jetë. Për arsye të vlefshme, jo egoiste, çiftet mund të shtyjnë për më tutje vendimin për të sjell në jetë një fëmi duke krijuar në këtë mënyrë një situatë të qënit baba e nënën më të përgjegjshme. Përmbajtja e përkohshme dhe rregullimi i lindjeve të bazuara mbi vetë vështrimin janë konform me kriteret objektiv të moralitetit. Duke marrë parasysh seriozitetin e ambjentit në të cilin mblidhemi duhet të pranojmë pa frikë se shumë çiftet katolikë, edhe ato të cilët kërkojnë të jetojnë seriozisht martesën e tyre, nuk ndjehen të detyruar të përdorin vetëm metoda naturale dhe kjo nuk është ndryshe as në Equipe Nôtre Dame. Duhet shtuar që zakonisht këto zgjedhje nuk vihen në dyshim nga ana e rrëfyesve. Nga njëra anë çiftet janë të hapura ndaj jetës dhe refuzojnë abortin nga ana tjetër nuk arrijmë të kapim aspektativat dhe pritjet shpirtërore të Humanae Vitae. Kontrolli i lindjeve me anë të metodave naturale është teorikisht i mirë; por në kulturën e sotme duket se është pak praktik. Çiftet sidomos ato të rejtat jetojnë një ritëm jete që nuk i lejon të praktikojnë këto metoda pasi të tilla metoda kërkojnë kohë për tu mësuar dhe koha është diçka shumë e çmuar në botën në të cilën jetojmë sot. Ajo çfarë është më e keqa, është fakti që e shpjeguar në mënyrë sipërfaqësore, në mënyrë jo korrekte, metoda naturale merr keshtu një famë të padrejtë si një metodë pak e sigurt dhe shpeshherë pa efekt. Arsye përse, akoma edhe një herë, duhet pranuar sinqerisht që një gjë e tillë nuk ndiqet na shumica e çifteve katolike. Kur kontrollim i lindjeve është e domosdoshme, një nevojë, çiftet, nuk refuzojnë përdorimin e kontraktivëve. Në përgjithësi nuk e konsiderojnë si diçka të turpshme apo një problem moral. Duhet edhe të konsiderojmë që raportet seksuale janë të orientuar drejt një përcjellje jete por gjithashtu edhe në shërbim të jetës bashkëshortore. Kjo nuk është diçka mahnitëse duke marrë parasysh nevojat e ligjeve dhe forcën e instiktit seksual. Por ajo çfarë nuk është normale është fakti që shumica e çifteve katolike është e zhytur në ankth. Lëvizja Equipe Nôtre Dame ka formuluar vite më parë një studim, që mban titullin Të Ungjillizosh seksualitetin. Në këtë dokument konstatojmë ndryshimin midis doktrinës morale dhe jetës së përditshme të çiftit. Me që bëhet fjalë për një çështje të rëndësishme, filloi kështu të bëhet i rëndësishëm brenda në lëvizje edhe studimi i bazuar mbi katekizmin dhe teologjinë e trupit, të S. Giovanni Paolo II, me titull "Teologjia e seksualitetit" ("La Teologia della sessualità"). Ati i Shejtë, Etërit sinodal, zonja dhe zotërinjë, do të ishte një inkurajim i madhë nëse çiftet takonin dritë dhe mbështetje bashkë me klerikët. Shpeshherë këshilla të kundërta mund të krijojnë e përkeqësojnë ç'orientimin e konfuzionin e tyre. Kërkojmë që Magjisteri të shpejtojë për ti dhënë Etërit dhe besimtarëve udhëzimet e përgjithshme të një pedagogjie pastorale në mënyrë që të

ndihmojë për të aplikuar dhe respektuar parimet të vendosura nga Humanae Vitae. Është e nevojshë dhe urgjente një orientim i lehtë dhe i sigurt që ti japë një përgjigje nevojave të botës së sotme, pa lënduar thelbin e moralit katolik i cili ka nevojë të përhapet gjërë e gjatë. E mbyllim duke përsëritur besimin tonë të plotë dhe të pakushtëzuar ndaj Jezu Krishtit me anë të Atit të Shejtë dhe të Kishës.

<http://press.vatican.va/content/salastampa/it/bollettino/pubblico/2014/10/09/0734/03017.html>

## **Fjalime të çifteve të tjera në Mbledhje (Sinodo)**

Ron e Mavis Pirola, bashkëshortë australian (Equipe Nôtre Dame e worldwide Marriage Encounter), 55 vjet bashkë. Nënvizuan rëndësinë e “intimitetit seksual”, thelb i jetës në çift e nënkuptuar në mënyrë katolike. E përshkruan bashkimin seksual si një pjesë të domosdoshme të jetës së tyre shpirtërore “gjë e cila duke e studjuar më thellë do të jetë e mundur të vlerësohet bukuria e të mësuarit ashtu siç Humanae vitae”. Shpjeguan se si “Kisha shtëpiake” ka shumë për të dhënë kishës universale për mënyrën e ungjillëzimit, gjithmonë në mëdyshje midis “tensionit për të pohuar të vërtetën” dhe nevojës për të shprehur “keqardhje dhe mirëkuptim”. Një shembull? Dy shokë, prindër të një djali homoseksual, për krishtëlindje ju desh të përballëshin me kërkesën e tij për të sjell në familje ku ishin të pranishëm dajallarë xhaxhallarë halla teze e nipër e mbesa “shokun e tij”. Përgjigja e tyre mund të përmblihet në tre fjalë: “Është djali ynë”. Sipas Pirola, është kjo mënyra e “metode ungjillëzimi” që kishat duhet të mësojnë nga kishat shtëpiake të cilat janë familjet.

Jeff e Alice Heinzen, nga Shtetet e Bashkuara (Instituti për Martesa dhe Jeta Familjare e dioqezash di La Crosse): “Im shoq dhe unë e kuptuam që prindërit tanë kanë shfaqur në veprimet e tyre të përditshme imazhin e Zotit në brëndësi të martesës dhe të familjes”. “Na kujtohen puthjet e ëmbla që prindërit tanë shkëmbejnë vazhdimisht, lutja e mbrëmbjes për të kërkuar bekimin e Hyjit mbi të gjithë familjen; pastaj ja dhe nënat tona të cilat na këshillonin të kursenim lekë për të ndihmuar ata të cilët ishin më me pak fat se ne”. Për ata: “dëshmia e prindërve tanë rreth bukurisë së planit të Zotit është besnik”. Pohan se: “kur flasim për fjalën e Zotit për të shërbyer, martesa duhet të përfshihet në çdo program që propozohet si një njohje për thërritjen e Hyjit”. Një çift me fe të ndryshme, por e përfaqësuar në Takim vetëm nga gruaja, Jeannette Touré, Presidente Kombëtare e Shoqatës Gratë Katolike të Kosta d'Avorios

(Presidente Nazionale dell'Associazione Donne Cattoliche della Costa d'Avorio), e martuar me një mysliman, pesë fëmijë dhe gjashtë nipër dëshmon: “ Pesëdhjetë e dy vite jetë bashkë në tolerancë, në respekt të përbashkët kundrejt besimit tonë të ndryshëm fetar, në përkrahje ndaj njëri-tjetrit, në edukimin katolik të fëmijëve tanë (të gjithë të pagëzuar në kishë,dhe kjo gjë dakort më burrin tim”. Familja, tha ajo, është “i vetmi vënd ku mund të jesh vetvetja duke hequr çdo maskë pa u gjykuar, vendi në të cilin mësojmë se si të besojmë në vetvete nën shikimin plot dashuri e të shëndritshëm që prindërit duhet të kenë për fëmijët e tyre, vëndi ku jetohet dashuria e përditshme, vendi në të cilin mund tja mbathim nga vetmia dhe ku mësohet bashkëjetesa.”.

Stephen e Sandra Conëay: plagët e falimentimit dhe të ndarjes “Në 2008, pas 21 vjet martesë, mardhënja jonë kishte prekur fundin...u paraqita tek prifti im, i cili më dëgjoi në zemër e më vuri në duar dépliant të Retrouvaille”. Falë atyre takimeve “lidhja jonë martesore u ungjillëzua. Kisha u bë për ne shtëpia e Babait, me dyert e hapura, një vënd për ne dhe për problemet tona”. Tani merren me çiftet që janë në krizë, merren me problemet të cilat ndërhyjnë në një moment të caktuar të jetës në çift: “ mënyra e të jetuarit single të martuarve”, domethënë “një çift i martuar që sillen si dy persona të cilët çdokush shikon jetën e tij. Shpeshherë kjo mënyrë e të jetuarit fillon në pafajsi, por në vazhdim e tutje gërrmon një gropë midis tyre e cila nuk i shtyn veçse në rrugë të ndryshme”. Pastaj çdokuh shkon në rrugën e tij: “ është pikërishtë në fazën e vuajtjes që shumë persona dorëzohen”. Oliver dhe Xristilla Roussy, 20 vjet të martuar, me prejardhje familjare shumë të ndryshëm - ai nga një familje e madhe ndërsa ajo nga prindër të divorciuar - që të dy kishin gjithmonë dëshirën të krijonin një familje të madhe dhe të bukur. Falë ardhjes në jetë të fëmijëve, gjithsej shtatë, dy bashkëshortët tregojnë se si arritën të “shkëputnin vëmendjen nga vetvetja dhe të tejkalonin limitet e lodhjes dhe të sikletit”, edhe duke përdorur metodat rregullimit natural: “ ishte e jona zgjedhja dhe nuk është diçka e pësuar nga të tjerët, dhe na jep një gëzim të thellë edhe pse këron shumë sforcime.”, thanë çifti i martuar, duke shpjeguar që zgjedhja e tyre është “më shumë se një metodë, është një mënyrë e të jetuarit” që i lejon të “ pranojnë njëri tjetrin , të komuikojnë të njihen, të presin, të shkëmbejnë mendime të ëmbla dhe gjëra intime”. Bëjnë pjesë të Komunitetit Emmanuel,e cilat merret me mirëpritjen e familjeve në situata nga më të dëshpëruarat, cilado qoftë historia dhe kultura e tyre: shpeshherë janë “çifte jo të martuar, prindër të vetmuar, të divorciuar, të martuar sërish” dhe “ Shpirti i Shejtë i vendos gjatë rrugës sonë që ne ti duam dhe ti shtrijmë dorën për ti ndihmuar (...) me

kurajo, zemër e bimirësi, sipas teorisë së gradualitetit, i propozojmë çdokujt të ndjekë Krishtin duke bërë nga një hap çdo ditë”.

## **Një pikë e kuqe mbi hartën e historisë së Kishës**

Historia e Kishës është e lidhur nga pikë të kuqe: “shenja të rëndësishme ” për tu kujtuar në historinë e saj mijra vjecare dhe sigurisht për tu kujtuar ishte edhe kjo mbledhje (Sinodo) mbi familjen. Në këtë artikull do të përpiqemi të pëshkruajmë pjesët më të rëndësishme të pjesës së parë të këtij takimi mbi familjen, pa u ndaluar shumë mbi opinionet. Siç ishte e parashikuar nga një anë , mblodhi shumë gjykime të kundërta midis tyre nga të gjithë pjesmarrësit: paragjykime të “ftohta” nga ana e progresistëve dhe të “hapje të paevitueshme” nga ana e konservatorëve. Me pak fjalë gjithkush ka diçka për tu ankuar, por të shumtë dhe të pamohueshëm ishin ndryshimet që papa Françesku deshi të kryej për të njohur më mirë ndryshimet në familjet e ditëve të sotme. Vetëm pak ditë më parë mbaroi Mbledhja e Jashtëzakonshme (Sinodo Straordinario) mbi familjen me premtimin nga papa Françeskun për të gjithë peshkopët për të meditar arsyetuar, llogjikuar mbi dokumentin final “Relatio Synodi” për tu takuar më pas në tetor të 2015 për të marrë së fundim një vendim mbi pastorët familjarë. Por ku filloi e gjithë kjo? E gjithë kjo fillon me aktin e parë i cili ka për protagonist papa Françeskun personalisht. Në korrik të 2013, në konferencën për shtyp mbi avionin që po e risjell në Romë pas udhëtimit të tij në Brazil, ai lëshon dy mesazhe të cilat kanë një impakt të fortë dhe që zgjati në kohë. I pari mesazh ishte ai mbi trajtimin e homoseksualëve: “Nëse një person është gay dhe kërkon Zotin dhe ka vullnet të mirë kush jam unë për ta gjykuar?”. Mesazhi i dytë është ai mbi pranësën e martesave për të dytën herë: “ Një sqarim: ortodoksët ndjekin teologjinë e ekonomisë, siç e quajnë ato, dhe japin një shanc të dytë [për martesë], e lejojnë. Besoj se ky problem – mbyll këtë sqarim – duhet studjuar në kornizën e pastorale matrimoniale”. Vazhdon thërritja e Mbledhjes (Sinodo)në dy pjesë e pas ndikimit të mbledhjes i bashkohet lëshimi i një pyetësi në nivel botëror me pyetje specifike mbi çështje nga më të ndryshme, përfshirë edhe kungimi i të rimartuarve dhe bashkimi midis homoseksualëve (hera e parë në absolut). Pyetësori i cili pati si pjesmarrës dhe përfshiu të gjithë laikët botëror ,tjetër aspekt absolutisht i ri, dhe që na përfshiu edhe ne si lëvizje END. Mënjëherë u hapën diskutime brënda për brënda Kishës mbi dy temat e lartë përmendura dhe mbi shumë tema të tjera si përgatitja për martesë, edukimi i fëmijëve mbi fenë dhe martesat me prejardhje të

ndryshme fetare. Arrijmë kështu më 5 tetorë, dita e hapjes së Jashtëzakonshme (Sinodo Straordinario), në të cilën papa Françesku i kërkon të gjithëve të mos fshihen, të flasin qartë dhe të dëgjojnë të tjerët: “ ju kërkoj ju lutem të keni këtë sjellje si vëllezër të Zotit: të flisni me sinqeritet e të dëgjoni me durim”. Mbledhja (Sinodo) është e ndarë në pjesë të ndryshme, gjatë pjesës së parë diskutimet ndjekin një rrugë të “Instrumentum Laboris” i cili është një dokument përmbledhës të pyetësorëve të ardhur nga e gjithë bota. Gjatë kësaj faze diskutimi morën fjalën 13 çifte të ardhur nga e gjithë bota me përkatësi nga të gjithë lëvizjet shpirtërore për çiftet dhe familjet. Ndër to ishte dhe një çift i cili bën pjesë në lëvizjen END, dhe është përgjegjëse e super-rrethit të Brazilit: i Zamberline. Në fund të diskutimit u shkrua një dokument “Relatio Post Disceptationem”. Dokument i cili edhe pse akoma jo përfundimtar vjen menjëherë i "grisur" nga të dyja palët nga progresistë dhe nga konservatorët. Në faqet e internetit dhe mbi gazeta u shfaqen shumë komente të forta nga të dyja palët. U kalua kështu në fazën e ashtëquajtur “të rretheve më të vegjël” në të cilën mbledhja u nda duke marrë si kriter gjuhën: 2 rrethe franceze, 3 anglese, 3 italjane dhe 2 spanjolle. Këto rrethe bënë një vlerësim më preciz të dokumentit të ndërmjetë të Mbledhjes (Sinodo), të “Relatio post Disceptationem” dhe dhanë sygjerime të ndryshme për redaktimin final të “Relatio Synodi”. Mbledhja ( Sinodo) u mbyll nga papa Françesku i cili me anë të një falenderimi të madh për të gjithë duke konsideruar që gjatë rrugës së mbledhjes (Sinodo) pati momente entuziazmante e plot pasion por edhe momente zhgënjimi dhe tentimi dhe kjo mund të jetë : “ tentimi për një mbylljeje armiqësore, domethënë dëshira për tu mbyllur brënda fjalëve të shkruara pa pasur dëshirë për tu befasuar nga Zoti, nga Zoti i surprizave” ose “tentimi i të mirës shkatërruese, e cila në emër të një mashtruese bamirësie fashon plagët pa i kuruar më parë” ose akoma “tentimi për të shndërruar një gur në bukë për të dërprerën një periudhë të gjatë pangrënjeje, të rëndë dhe plot dhimbje edhe duke shndërruar bukën në gurë për të goditur pektorët, të dobëtit e të sëmurët” ose “tentimi për të zbritur nga kryqi, për të kënaqur njerëzit, dhe të mos qëndrosh për të kryer dëshirën e të Atit” ose së fundmi “tentimi për të lënë pas dore “depositum fidei”, duke mos u konsideruar mbrojtës por pronar dhe të zotët ose nga ana tjetër, tetimi për të lënë pas dore realitetin duke përdorur një gjuhë të zvogëluar e të fryrë për të thënë shumë gjëra e në të njëjtën kohë për të mos thënë asgjë! Besoj, këto gjëra.... i quanin “bizantinismi”...”. Së fundmi papa Françesku mbyll duke thënë “tani kemi akoma një vit për tu rritu, me një kriter shpirtëror të vërtet , me idetë e propozuara dhe gjetja e zgjidhjeve konkrete të vështirësive të shumta e të sfidave të pafund që familjet duhet të përballojnë; ti japim përgjigje situatave të pashpresa që rrethojnë e mbysin

familjet”. Dhe kjo na vë në punë të gjithë për të ndihmuar dhe përkrahur Kishën në këtë kalim kaq delikat, duke lexuar dokumentin final të “Relatio Synodi”, duke u ndihmuar nga këshilltarët shpirtëror në pjesët më të vështira e duke sjellë kontributin tonë duke menduar në thelësi në dioqezën tonë.

Bruna e Giovanni Sica